



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28 Janar 2022

Nr: 27

VENDIM

PËR

LIRIM DHE EMËRIM TË ANËTARËVE TË KZAZ NR. 4, QARKU SHKODËR, TË KZAZ NR. 22, QARKU DURRËS SI DHE ZËVENDËSIMIN E SEKRETARËVE TË KZAZ NR. 4 DHE KZAZ NR. 5, QARKU SHKODËR

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ç”, e 2, 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, janë kërkuar zëvendësime të anëtarëve në KZAZ-të si më poshtë:

Partia Socialiste e Shqipërisë, me shkresat nr. 264 prot., datë 27.01.2022, dhe nr. 298 prot., datë 28.01.2022 ka kërkuar zëvendësimin e anëtarëve të KZAZ nr. 4, qarku Shkodër, KZAZ nr. 22, qarku Durrës dhe zëvendësimin e sekretarit të KZAZ nr. 4, qarku Shkodër dhe Partia Demokratike, me shkresën nr. 312 prot., datë 28.01.2022 ka kërkuar zëvendësimin e sekretarit të KZAZ nr. 5, qarku Shkodër.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 29, pika 1, shkronja “c”, 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.



PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ç”, e 2, 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra anëtarin e KZAZ nr. 4, qarku Shkodër, z. Saimir Beqiraga dhe anëtarin e KZAZ nr. 22, Qarku Durrës, z. Ervis Lila.
2. Të emërojë anëtarë të KZAZ nr. 4, z. Arlind Sylja dhe anëtarë të KZAZ nr. 22, z. Shpëtim Ciku.
3. Të zëvendësojë sekretarin e KZAZ nr. 4, qarku Shkodër, z. Spartak Dibra me z. Arlind Sylja si dhe sekretarin e KZAZ nr. 5, qarku Shkodër, z. Nikolin Guri me z. Sadet Osmani.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

